



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.117/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINE- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ-komercial sipas padisë së paditësit, NPT Florenti me seli në Mitrovicë i përfaqësuar nga V.M avokat nga Mitrovica kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, gjobë administrative, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.160/2018 të datës 17.06.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.09.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit NPT Florenti me seli në Mitrovicë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.160/2018 datës 17.06.2020, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NPT Florenti me seli në Mitrovicë, dhe është lënë në fuqi vendimi nr.526/2017 datës 29.12.2017 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ushtron përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, për shkak se në procedurë që i ka paraprirë vendimit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, me

propozim që të aprovohet ankesa, dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar. Padiësi ka qenë i pajisur me arkë fiskale mirpo si rezultat i neglizhencës së puntorve, porosia e dorëzuar në një tavolinë nuk ka qenë e shoqëruar me kupon fiskal, gjë për të cilën i është shqiptuar gjobë për një kupon fiskal prej 1,000.00€, në vizitën e dytë dt.31.07.2017 ka ndodhur i njëjti incident ku nga 25 tavolina në vetëm 5 prej tyre nuk ka pasur kupon fiskal kjo si rezultat i shpejtësisë së punës dhe pamundësisë që në të njëjtën kohë bashkë me porositë të dorzohen edhe kuponat fiskal. Shqiptimi i dënimit është tejet i lartë dhe nuk është në proporcion adekuat për të arritur qëllimin e caktuar, Sipas padiësit është dashur të aplikohen dispozitat ligjore të nenit 53 apr.2 nënp.2.2 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i cili parasheh se tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej 30 deri 200 mij euro i shqiptohet ndëshkimi prej 250€, ashtu që për 6 kuponët fiskal vlera e përgjithshme e ndëshkimit duhet të arrijë totalin prej 1,500.00€

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.(H) të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur Administrata Tatimore e Kosovës nr.526/2017 të dt.29.12.2017, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë NPT Florenti me seli në Mitrovicë, dhe i ka vërtetuar si të bazuara Dokumentet mbi vendosjen e ndëshkimeve në vlerë prej 6,000.00€ të vendosur sipas nenit 53.6 të Ligjit 03/L-222. Në arsyetim të vendimit administrativ theksohet se Departamenti i Ankesave pas verifikimit të raportit të vizitës dt.19.08.2017 dt.31.07.2017 dhe bazuar në Ligjin 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 132.2, konstaton se ankesa e tatimpaguesit është e pabazuar në ligj. Tatimpaguesi është i obliguar që në qdo rast të respektojë dispozitat ligjore me Udhëzimin Administrativ 01/2015 neni 4 paragrafi 1 nënp.1.1 dhe nënp.1.3 për Shfrytëzimin e paisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale. Ndëshkimet janë lëshuar duke u vërtetuar gjendje faktike në momentin e caktuar kohor gjatë vizitave vëzhguese të inspektorëve ku është konfirmuar se nuk kishte lëshuar kupon

fiskal gjatë shërbimit të klientëve. Andaj vendimi i inspektorit është i bazuar në nenin 53.6 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit, subjekti ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ-komercial në Gjykatë të shkallës së parë, e cila në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me dt.17.06.2020, dhe pas administrimit të provave për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, dhe e lën në fuqi vendimin kontestues të organit të paditur.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar vendimin duke u mbështetur në bazën ligjore të vendimit kontestues, neni 53 paragrafi 2 nenp 2.4 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, pasi që paditësi ka qarkullim prej 500,00€ e më lartë si etnitet i vetëm, dhe në këtë rast janë konfirmuar konstatimet e paditues, se paditësi nuk ka lëshuar kupona fiskal klientëve që parashihet me dispoziten ligjore të nenit 53 par.6 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit dhe konstatoi se vendimi kontestues i Administratës Tatimore të Kosovës është plotësisht i drejt dhe i bazuar në ligj.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-vendimit të atakuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, në të cilin vendim në procedurë administrative e gjithashtu sipas aktgjykimit të ankimuar me ankesë, edhe në procedurë gjyqësore në mënyrë të plotë

është vërtetuar gjendja faktike e çështjes në shqyrtim, se tatimpaguesi-paditësi, nuk ka lëshuar kuponët fiskal për klientët e tij, e që me këtë veprim, paditësi, ka rënë ndesh me nenin 53 par.6 të Ligjit nr.03/L-222, ku sipas kësaj dispozite parashihet që “Çdo person i cili kërkohet të vonesë një pajisje elektronike fiskale për regjistrimin e transaksioneve të bëra gjatë aktivitetit të tyre ekonomik dhe i cili nuk i lëshon klientit të vet kupon nga pajisja e tillë e fiskalizuar, do të detyrohet për një gjobë e përcaktuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni. Në rast të dështimit të pajisjes apo rrymës, duhet të lëshohen kuponët e shkruar me dorë të cilët janë miratuar nga administrata tatimore në vend të kuponit të lëshuar nga një pajisje elektronike fiskale, që i nënshtrohet ndëshkimit të përshkruar në këtë paragraf”.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, Kolegji i Dhomës së Dytë, nuk i aprovoi, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se është dashtë të aplikohen dispozitat ligjore të nenit 53 par.2 nënp.2.2 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i cili parasheh se tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej 30 deri 200 mij euro i shqiptohet ndëshkimi prej 250€, ashtu që për 6 kuponët fiskal vlera e përgjithshme e ndëshkimit duhet të arrij totalin prej 1,500.00, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë nuk i aprovoi si të bazuara, ngase paditësi në ankesë nuk ofron prova konkrete lidhur me kontestimin e gjendjes faktike të çështjes sipas mënyrës së vendosur si në organin e paditur dhe në gjykatën e shkallës së parë. Nuk ekzistojnë prova të ofruara nga paditësi për të dëshmuar qarkullim vjetor, me qëllim që të shqyrtohen pretendimet në kuptim të lartësisë së gjobave administrative të shqiptuara nga inspektor tatimor, për mos lëshim të kuponave fiskal.

Kolegji, i refuzoj si të pa bazuara pretendimet tjera të paditësit, i cili me rastin e ofrimit të shërbimeve klientëve, nuk iu ka lëshuar kupon fiskal, në momentin e regjistrimit të shërbimit në PEF, e që është në kundërshtim me nenin 21 par 1.2 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, i cili nen përcakton se: “Printimi dhe dhënia e kuponëve fiskal konsumatorëve është i detyrueshëm në momentin e regjistrimit të furnizimit në PEF”. Gjersa është fakt i pa mohueshëm se, inspektori tatimor gjatë vizitave vëzhguese tek

paditësi ka vërejt se tatimpaguesi-paditësi nuk lëshon kupon fiskal në momentin e kryerjes së shërbimit të klientëve të tij, e që është në kundërshtim me nenin 21 par1.2 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe organi administrativ përfundimtar Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore e procedurale dhe materiale për ATK-në, dhe nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet në ankesë nuk aprovohen dhe nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, kështu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet si drejtë, dhe i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 200 të LPK-së, dhe nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.117/2022 datë 05.09.2022

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Krenar Berisha